

KONTRATE SHITJE

Palet ne kete kontrate jane:

1. **SHITESI** - Dritan Dakoli, i biri Hakiut, lindur ne Tirane me 1967, banues ne Tirane Rruga "Tefta Tashko", Pall 132, Shk.1, Ap.14
2. **BLERESI** - Renis Tershana, i biri i Agimit, lindur ne Tirane me 1971, banues ne Tirane

Meqenese Dritan Dakoli, ortak i shoqerise "R & T" sh.p.k, me shkresen e dates 15.07.1996 ka shprehur vullnetin e tij per te shitur (transferuar) pjeset e kapitalit themeltar ne masen 50% qe ai zoteron ne kete shoqeri, dhe

meqenese Renis Tershana, ortaku tjetër i shoqerise "R & T" sh.p.k. me shkresen e dates 19.07.1996 ka njoftuar deshiren per te ushtruar te drejten e parablerjes,

palet bien dakort te lidhin kete kontrate shitje te pjeseve te kapitalit me kushtet e meposhtme:

Neni 1 Objekti

Shitesi me vullnet te lire shet, ne favor te blesetit, pjeset e kapitalit themeltar prej 50% qe ai zoteron ne shoqerine "R & T" sh.p.k., me qender ne Tirane, me kapital 100.000 leke.

Neni 2 Vlefte

Shitja pjeseve te kapitalit, permendur ne piken 1(nje) ketu me siper, behet me nje cmim total prej 50.000 (pesedhjetemije) leke.

Neni 3 Pagesa

Palet e kesaj kontrate kane kryer te gjitha veprimet perkatese te likujdimit dhe nuk kane asnje pretendim ndaj njeri tjetrit.


Neni 4

Shitja e pjeseve te kapitalit si me siper behet ne perputhje me kerkesat e nenit 6 te Statutit te dispozitave te Ligjit 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe Kodit Civil. 20.12.1998

Neni 5

Kjo kontrate eshte hartuar ne kater kopje origjinale, nga te cilat nje per t'u depozituar ne noteri, nje prane regjistrit tregtar dhe nga nje per sejcilen pale.

SHITESI
Dritan Dakoli

Dritan Dakoli


BLERESI
Renis Tershana

RENIS TERSHANA
